REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 743/20
Datë/Datum. 21.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues	***Data e autorizimit të ekspertit*** 14.10.2020	*Data e dorëzimit të raportit* 21.10.2020

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.10.2020, OE NPN"Renelual Tahiri"shpk - Prizren , ka parashtruar ankesë me nr:743-20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Intervenimi ne infrastrukturën per rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale ne Komunen e Prizrenit" me nr. të prokurimit, 622-20-4624-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prizren.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, të negociuar,të kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 1 500 000,00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE, përmes ankesës pretendon se AK nuk ka respektuar dispozitat e LPP-se:

Neni 1, 7, 27, 69 LPP dhe neni 18.9 dhe 26.4, te RrUOPP-se

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Të nderuar AK-ja me dt. 21.08.2020 keni publikuar tenderin me titull **"Intervenimi ne infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit 622-20-113-211".**

AK-ja ka vendosur kërkesa dhe dëshmi dokumentare shumë kundërthënëse dhe me dy kuptimësi, *sepse tek*

neni 9.1&9.2 i FDT-së ka kërkuar **Kërkesa 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 2.000.000,00 €,** ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare ka kërkuar **"Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojne vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.**

Pra te dëshmia fillimisht e ka cekur kontrata të natyrës së kërkuar, ndërsa në fund të dëshmisë e ka cekur vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre. Kurse tek kërkesa e ka cekur vetëm projekte të natyrës së kontratës.

Nëse shikohet paramasa atëherë vërehet se natyra e këtij aktiviteti të prokurimit dallon me shërbime të kryera sepse në këtë aktivitet të prokurimit parashihen të kryhen punë në shumicën e pozicioneve, pastaj parashihen furnizime gurë te mëdhenj, furnizime me gurë të thyer të fraksioneve të ndryshme, furnizim me gurë zhavori natyral etj., prandaj nëse merret parasysh natyra e këtij aktiviteti të prokurimit është dashur të kërkohen dëshmitë kontrata dhe referenca për punë të ngjashme ku do të hynin, asfaltimi, rehabilitimi, mirëmbajtja, furnizimi, ndërtimi etj. e jo siç e ka cekur AK-ja tek dëshmia e kërkuar dokumentare **të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.** Pra AK-ja tek dëshmia e kërkuar dokumentare fillimisht e ka cekur projekte të natyrës së kontratës, e që natyra e kontratës përfshinë aktivitet si punë, furnizime, shërbime etj., ndërsa tek fjalia e fundit e dëshmisë dokumentare ka shënuar se duhet ofruar **dëshmi referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve.** Pra edhe brenda dëshmisë së kërkuar dokumentare ka kundërthënie, përveç asaj se dëshmia e kërkuar dokumentare është në kundërshtim me kërkesën sepse tek kërkesa shkruhet dhe kërkohet vetëm **për Projektet e natyrës së kontratës**Gjithashtu edhe titulli i këtij aktiviteti të prokurimit i emërtuar **"Intervenimi në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrorc dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit",** nënkupton se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë kryesisht me asfaltim të rrugëve, fumizim etj. prandaj nuk është dashur të cilësohet kjo kontratë si kontratë për shërbime por si kontratë punë dhe ti vendoset numri 5 për të dëshmuar këte fakt.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kërkes 1. Projektet e **natyrës së kontratës** realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuarnga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 2.000.000,00 €

Deshmia Dokumentare
Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosienelektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e

shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

S'ka

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prizren, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113) : Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontrate përkatësisht kundër kërkesës se aplikuar ne dosje te tenderit te pikës 9.1&9.2, kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional qe ndërlidhet me projektet e realizuara ku përveç tjerash per operatoret ekonomik per tu kualifikuar si te pergjegjeshem është kërkuar te prezantojnë, projekte te natyrës se kontratës.

- Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore përkatësisht po t'i referohemi para masës dhe para llogarisë se këtij aktivitetit te prokurimit, rezulton qe natyra e aktivitetit te prokurimit ka te beje me kontrate "**kombinim**", ku përfshihen shërbime, pune dhe furnizime.

Sipas nenit 15.3, te RrUOPP-se, cilido element i kontratës i cili ka shpenzimet me te larta duhet te klasifikohet nen atë lloj te kontratës. Megjithatë AK/ Komuna prizren, me kërkesën e kualifikimit e aplikuar kundrejt operatoreve dhe te kontestuar nga parashtruesi i ankesës "*...projekte te natyrës se kontratës...*", mund te kufizoj konkurrencën apo edhe te favorizoj operator ekonomik te caktuar, prandaj propozimi ynë është qe te mundësohet operatoreve te ofertojnë me "*Projekte (te realizuara) te ngjashme me aktivitetin e prokurimit*", me qellim qe te zgjerohet konkurrenca.

Prove shkresore, se bashku me rapor, gjeni kopjen e para masës dhe para llogarinë

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE NPN"Renelual Tahiri"shpk – Prizren, te **aprovohet si e bazuar**. AK- Komuna Prizren, t'beje korrigjimet e mundeshme ne dosje te tenderit dhe t'i njoftoj OE-te, te inderesuar konform dispozitave te nenit, **53.7, te LPP-se.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Prizren.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - NPN"Renelual Tahiri"shpk - Prizren.

Titulli : Intervenime në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore, rrëshqitja të dheut, përmbytjet dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e P

Paramasa dhe parallogaria

Nr	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së 18 %	Çmimi njësi (me TVSh)	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali me TVSH
A	Pastrimi dhe largimi dherave nëpër rrugë								
A.1	Identifikimi dhe shënimi I vendeve për rastet ku duhet bërë ndërhyrja dhe intervenimi.	Pa njesi	1.0						
A.2	Transporti i makinerisë së nevojshme për ndërhyrje (eskavator, bulldozer, grejder , damper, cilinder) deri ne vendin e paraparë për kryerjen e punimeve.	Transport	1.0						
A.3	Pastrimi dhe largimi I dheut të rrëshqitur nga terrenet e pjerrëta jo stabile (rrugët, bjeshkë, kodrinat etj) dhe transporti deri deponin e qytetit në në çmim duhet përfshirë edhe taksën e deponisë.	m³	1.0						
A.4	Zgjerimi, gërmimi dhe largimi i dherave dhe të tjerave , transporti materialeve deri në deponin e caktuar nga org. kompetente deri ne largesi 15 km .	m³	1.0						
A.5	Punime me makineri të nevojshme për kryerjen e punimeve në teren. Makineritë nga 6t deri ne 24t (buldozer, eskavator, grejder, damper, cilinder etj).	orë (h)	1.0						
A.6	Pastrimi , kositja , prerja dhe largimi I pengesave nga brezat anësore të rrugëve sikurse janë : drunjët, barërat, shkurret, gurët, rërë, dhera etj. dhe transoprti I tyre deri ne deponi.	km	1.0						
A.7	Largimi , prerja dhe krasitja drunjëve , lisave, shkurreve të thata që paraqesin rrezik dhe pengesa në rrugë , transoprti I tyre deri ne deponi sipas kërkesave të org. përgjegjëse.	m³	1.0						
A.8	Mirëmbajtja , largimi dhe pastrimi i rrugeve, trotuareve nga reshjet e mëdha të borës gjatë stinës dimrit, kryposja dhe largimi I akullit. Makinerit e nevojshme: kamion, kamion me lugë, grejder, buldozer, ngarkues, makinë përkatese dhe eskavator.	km	1.0						
								Total A:	

B	Furnizim me materiale dhe intervenime në raste intervenime emergjente	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së 18 %	Çmimi njësi (me TVSh)	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali me TVSH
B.1	Gërmimi , hapje, pastrimi , largimi i materialit dhe planifikimi I terenit , transporti deri në deponin e caktuar nga org. kompetente deri në largesi 15 km .	m³	1.0						
B.2	Furnizim me gurë te mëdhenj 400 -1000 mm për mbrojtjen e tereneve jostabile nga rrëshqitjet , këto gurë duhet të vendosen me makineri në mënyrë të rregullt me një kënd të pjerrët për sigurimin terenit.	m³	1.0						
B.3	Furnzimi me material dhe punimi i mureve mbrojtëse nga betoni , kallupimi, armimi dhe betonimi. Punimi I mureve bëhet me dimensione duke iu përshtatur kushteve në teren dhe rasteve sipas vendit ku nevoitet ndërtimi .	m³	1.0						

B.4	Furnizimi me material si dhe punimi i mureve mbrojtëse me gabione, rrjetë kubike nga çeliku të fabrikuar me dim. sipas nevojës dhe vendit ku duhet te vendosen , mbushja e rrjetave kubike të bëhet me gurë natyral 60-120mm.	m^3	1.0						
B.5	Furnizimi me material gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm dhe transporti i materialit deri te vendi i caktuar në largësi deri 20 km.	m^3	1.0						
B.6	Furnizimi me material gurë të thyer fraksion 0-63 mm dhe transporti i materialit deri te vendi i caktuar në largësi deri 20 km.	m^3	1.0						
B.7	Furnizimi me material gurë të thyer fraksion 0-120 mm dhe transporti i materialit deri te vendi i caktuar në largësi deri 20 km.	m^3	1.0						
B.8	Furnizimi me material gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm . Në largësi deri 15 km.	m^3	1.0						
B.9	Furnizimi me material gurë të thyer fraksion 0-63.0 mm . Në largësi deri 15 km.	m^3	1.0						
B.10	Furnizimi me material gurë zhavori natyral. Në largësi deri 15 km.	m^3	1.0						
B.11	Shtrirja, planifikimi ,nivelizimi dhe ngjeshja e materialit të zhavorit me makineri te nevojshme .	m^2	1.0						
B.12	Intervenime në rrugët me kubëza nga betoni t=8 cm , për raste të ndryshme të demtimeve në rrugë, duhet të largohen kubëzat dhe pas kryerjes se punimeve rruga duhet te kthehet ne gjendjen e mëparshme, mbushje, ngjeshje, planfikim dhe nivelizim.	m^2	1.0						
B.13	Intervenime në rrugët me asfalt për raste të ndryshme në rrugë, ku duhet të prehet asfalti dhe pas kryerjes se punimeve rruga duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme , mbushje, ngjeshje,planfikim dhe riasfaltim.	m^2	1.0						
B.14	Largimi I skajoreve te demtuar si dhe pastrimi I terenit dhe furnizimi si dhe vendosja e skajoreve te rinjë me bazë betoni.	ml	1.0						
B.15	Prerja , thyerja e asfaltit dhe largimi I materilait ,përgaditja e vendit si dhe furnizimi me material si dhe asfaltimi I gropave me AB 22, AB16,AB11 të parapërgaditura me shtresat e nevojshme.	m^2	1.0						
B.16	Furnizimi me material si dhe punimi I leshesave pllakore (tombinave) me beton , kallupimi , armimi, betonimi.	m^3	1.0						
B.17	Furnizimi me material , punimi i armaturës (prerja,lakimi dhe montimi) armatura me diametër të ndryshëm , sasia në kg/m^3, vendosja sipas standarteve teknike .	kg	1.0						
B.18	Punime me makineri të nevojshme sipas kërkesës , makinerit nga 6t deri ne 24t (buldozer, eskavator, grejder, damper, cilinder etj).	orë (h)	1.0						
								Total B:	

C	Intervenime dhe mbrojtje nga përmbytjet dhe pastrimi lumejve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së 18 %	Çmimi njësi (me TVSh)	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali me TVSH
C.1	Pastrimi i kanaleve të hapura atmosferike me eskavator si dhe largimi i materialeve (mbeturinave) deri në deponin e qytetit në largësi L=15 km.	m^3	1.0						
C.2	Pastrimi si dhe hapja e lëshesave të cilat janë mbushur nga materiale të ndyshme inerte dhe të tjera dhe transporti i mbeturinave deri ne dep. e caktuar .	m^1	1.0						
C.3	Hapja e kanaleve me eskavator për punimin e lëshesave dhe kanalizimeve të reja dhe largimi i dheut të gërmuar deri në deponin e caktuar në largësi .L= 15 km min.	m^3	1.0						
C.4	Furnizimi me material zhavori, shtrirja, planifikimi fundit të kanalit me t=10 cm, dhe mbulimi i gypave anash dhe mbi gypa me material zhavori 0-32 mm .	m^3	1.0						

C.5	Furnizimi dhe montimi i gypave nga betoni i armuar me dimensione si më poshtë :								
C.5.1	Ø 400 mm	m^1	1.0						
C.5.2	Ø 500 mm	m^1	1.0						
C.5.3	Ø 600 mm	m^1	1.0						
C.5.4	Ø 800 mm	m^1	1.0						
C.5.5	Ø 1000 mm	m^1	1.0						
C.6	Furnizimi ,transporti dhe montimi gypave të brinjëzuar PE SN 8 me dimensione si më poshtë :								
C.6.1	Ø 315 mm	ml	1.0						
C.6.2	Ø 400 mm	ml	1.0						
C.6.3	Ø 500 mm	ml	1.0						
C.6.4	Ø 630 mm	ml	1.0						
C.7	Intervenime në raste emergjente për mirëmbajtje të ujësjellësit (furnizimi me gypa, pjesë lidhese fazonike etj.) riparimi dhe lidhjen e gypave te ujësjellesit me dimensione të ndryshme nga Ø 32-Ø90 .	ml	1.0						
C.8	Gërmimi dhe hapja e kanaleve me thellesi h=2.0-3.0 , mbushja e kanalit dhe largimi e materialit të tepërt deri në deponi.	m^3	1.0						
C.9	Furnizimi me material dhe punimi i kokave hyrëse dhe dalëse nga betoni , duke përfshirë kallupimin , montimin e armaturës e nevojshme dhe betonimin.	m^3	1.0						
C.10	Pastrimi i lumejve, përrockave me makineri dhe largimi i materialeve të grumbulluara në shtratin e lumit të cilat paraqesin rrezik për mbylljen ose rrjedhjen e ujrave .	orë (h)	1.0						
C.11	Pastrimi me eskavator, ngarkimi , transporti i mbeturinave të grumbulluara në shtratin e lumit dhe përrockave të cilat paraqesin rrezik për mbylljen e rrjedhjes së ujrave , transporti materialeve deri në deponin e caktuar .	m^3	1.0						
C.12	Largimi i ujrave me pomp për raste të ndryshme në raste emergjente.	h	1.0						
								Total C :	

D	Pastrimi i deponive ilegale në qytet dhe fshatra	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së 18 %	Çmimi njësi (me TVSh)	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali me TVSH
D.1	Ngarkimi dhe transporti i materialeve inerte nga deponit ilegale pranë rrugëve , shesheve dhe lagjeve të qytetit dhe fshatrave , bartja e tyre në deponin e caktuar .	m^3	1.0						
D.2	Pastrimi , ngarkimi dhe largimi I mbeturinave të ndryshme nëpër qytet dhe fshatra, bartja dhe transporti deri ne deponin e caktuar.	m^3	1.0						
D.3	Pastrimi i sipërfaqeve , rrafshimi dhe planifikimi i tyre me makineri.	m^2	1.0						
D.4	Furnizimi me material (humusi) për rregullimin e sipërfaqeve ,mbushja t=20 cm e dheut për siparfaqe të pastruara dhe mbjellja barit .	m^2	1.0						
D.5	Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ me lartësi deri në h=2m , për rregullimin dhe gjelbrimin e hapësirave të qytetit.	copë	1.0						
								Total D :	

E	Punime te ndryshme	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së 18 %	Çmimi njësi (me TVSh)	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali me TVSH
E.1	Demolimi i objekteve që paraqesin rrezik dhe objekteve tjera që janë si pengesa në planet rregullative , bartja e materialit të demoluar deri në deponin e caktuar nga org, mbikqyres , në çmim të parashihet edhe taksa e deponisë.	m^3	1.0						
E.2	Thyerja, demolimi dhe largimi i betoneve , transporti i materialit në vende të caktuara nga org. mbikqyrës duke përfshirë edhe taksën e deponisë.	m^3	1.0						
E.3	Punime me makineri të nevojshme (kompresor me gjenerator) për thyerjen e materialeve të forta .	h	1.0						
E.4	Punime me aparatura të nevojshme (fleks, hilta, saldime) për prerje dhe shpuarje të materialeve të forta .	h	1.0						
E.5	Furnizimi me elemente konstruktive nga çeliku , druri dhe montimi I tyre per sigurimin e objekteve te cilat paraqesin rrezik për qytetarët si dhe kalimtarët të cilët kalojnë pranë këtyre objekteve.	m^2	1.0						
E.6	Vendosja e rrethojave të përkohëshme për siguri të objekteve.	m^2	1.0						
E.7	Vendosja e tabelave paralajmëruese me qëllim të vëmendjes së qytetarëve për mbrojtjen e ambientit (tabelat të jenë me dimensione standarde).	copë	1.0						
								Total E :	

R E K A P I T U L I M I

Kate goria	Përshkrimi	Çmimi total me TVSH në €	Çmimi total i peshuar
A	**Pastrimi dhe largimi I dherave nëpër rrugë**		
B	**Furnizim me materiale dhe intervenime në raste emergjente**		
C	**Intervenimi dhe mbrojtje nga përmbytjet dhe pastrimi I lumjeve**		
D	**Pastrimi i deponive ilegale në qytet dhe fshatra**		
E	**Punime të ndryshme**		
	Çmimi i përgjithshem i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlere). Në bazë të nenit 52 të LPP-së		

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	
NËNSHKRIMI:	
DATA:	
VULA:	